



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanikut
Skupština Kacanik
Municipal Kacanik

01-Nr. 16-12362/2014
Kaçanik 30.04.2014

Në bazë të nenit 40.2(i) të Ligjit 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale, të dispozitave të Udhëzimit Administrativ 12/2012, për Përcaktimin e Emërimit dhe Numërimit të Adresave për Zonat e Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira, i MMPH-së e miratuar me dt. 03.07.2012, të nenit 6.2 (p) e Statutit të Komunës së Kaçanikut si dhe nenit 15.1(i) dhe 15.6 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30.04.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE LOKALE
QË NUK JANË TË EMËRTUARA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

I.

Me këtë Vendim formohet Komisioni për emërtimin e rrugëve lokale të cilat nuk janë të emërtuara në Komunën e Kaçanikut.

II.

Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve dhe atë; një anëtar e cakton Kryetari i Komunës, dy anëtarë i cakton Kuvendi i Komunës.

III.

Anëtarët e Komisionit të emëruar nga Kuvendit të Komunës janë:

1. Kemal Mërseli, dhe
2. Kadri Krivenjeva.

IV.

Komisioni ka për detyrë t'i propozoj emërtimet e rrugëve lokale të pa emërtuara për secilin lokalitet veç e veç, duke marrë për bazë Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor Nr.12/2012-Për caktimin e emërimit dhe numërimit të adresave, për zonat e qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira i datës 03.07.2012 dhe të njëjtat tëa propozoj Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

V.

Komisioni i përcaktuar është i përkohshëm dhe pas përfundimit të punës së tij për emërtimin e rrugëve lokale të pa emërtuara, pushon së vepruari.

VI.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset : Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.

VII.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi